



Crna Gora / Mali i Zi
Opština Ulcinj
Komuna e Ulqinit
Kabinet Predsjednika
Kabineti i Kryetarit

Br./Nr. 01-040/24-1794/2

Crna Gora - Mali i Zi			
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit			
09.12.2024			
Regjion - Region	Opština - Opština	Broj - Number	Prilog - Attachment
02-040/24-	576	1	

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi
tel: +382 30 412 050
e-mail: kabinet@ul-gov.me

Ulcinj/Ulqin, 07.12.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT- SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
Kryetares së Kuvendit/ Predsjednici Skupštine

KËTU/OVDJE

E nderuara/ Poštovna,

Në bazë nenit 58 paragrafi 1 aline 2 Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Vendimi i GjK MZ i 85/2022 – përmirësimi i Vendimit GjK MZ) dhe nenit 65 të Statutit të Komunës ("Fleta zyrtare e MZ – Regloret komunale", br. 48/2019 i 5/2024), në shtojcë ju dërgojmë propozim Vendimin mbi sufinansimin e adaptimit të fasadave të jashtëme të ndërtesave në territorin e komunës së Ulqinit të përgaditur nga Sekretariati për veprimtari komunale dhe banesore, që ta veni në rend të ditës në mledhjen e ardhëshme për ta votuar.

Na osnovu člana 58 stav 1 aline 2 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list CG", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 - Odluka US CG i 85/2022 - ispravka Odluke US CG) 65 Statuta Opštine ("Službeni list CG – Opštinski propisi", br. 48/2019 i 5/2024), u prilogu Vam dostavljamo, predlog Odluke o sufinansiranju adaptacije spoljnih djelova zgrada na teritoriji opštine Ulcinj, koju je pripremio Sekretariat za komunalnu i stambenu djelatnost, da bi je stavili u dnevni red u narednoj sjednici Skupštine radi glasanja.

Me rrespekt/ S poštovanjem,

Kryetari/Predsjednik

Genci Nimanbegu



Genci Nimanbegu

Në bazë të nenit 17, paragrafi 4 i Ligjit për mirëmbajtjen e objekteve të banimit (“Fletorja zyrtare e MZ”, nr. 41/16, 84/18, 111/22 dhe 140/22), nenit 27, paragrafi 1, pika 10 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (“Fletorja zyrtare e MZ”, nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22) dhe nenit 58, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fletorja zyrtare e MZ” – dispozitat e komunave”, nr. 48/19 dhe 5/24), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . 2024, ka miratuar

VENDIMIN

për bashkëfinancimin e adaptimit të pjesëve të jashtme të objekteve në terrotirn e Komunës së Ulqinit

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë vendim parashikohen kushtet, mënyra, procedura dhe kriteret e bashkëfinancimit të adaptimit të pjesëve të jashtme të objekteve të banimit dhe objekteve të banimit dhe afariste në territorin e Komunës së Ulqinit (në vijim: “Adaptimi”).

Neni 2

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të banimit dhe afarizimit në objektet banesore dhe banesore-afariste Komuna e Ulqinit mund të nis procedurën e bashkëfinancimit të adaptimit nëse me buxhetin vjetor të Komunës së Ulqinit janë parashikuar mjete për këtë qëllim.

Bashkëfinancimi i adaptimit bëhet deri në 50% të vlerës së përgjithshme të parallogaritur të punimeve të paraqitura në ofertën e kontraktorit, e më së shumti deri 25.000,00 € me TVSH-në e llogaritur.

Me përjashtim, Komuna mund të financojë edhe deri 100% të vlerës së përgjithshme të parallogaritur të punimeve, me pëlqimin paraprak të shumicës së pronarëve të njësisive të ndërtesës së banimit, nëse vlerëson se ka një interes të posaçëm publik, posaçërisht për shkak të avancimit estetik, të përmirësimit të sigurisë ose ruajtjes të të mirave publike.

Neni 2a

Me përjashtim nga nenit 2, ndërtesat më të vjetra se 30 vjet, me propozimin e Komisionit nga neni 7 i këtij vendimi, për hir të përmirësimit estetik, përmirësimit të sigurisë dhe interesit publik, mund të financohen deri në 70% në zonën PDU “Meraja 1”, PDU “Meraja 2”, PDU “Totoshi” dhe PDU “Pristan” nga vlera parallogaritëse e punimeve të deklaruara në ofertë kontraktori, dhe deri në 40.000.00 € me TVSH të llogaritur.

Neni 3

Adaptimi, në kuptim të këtij vendimi, është kryerja e punimeve në objektin ekzistues, me të cilat:

1. bëhet përpunimi i sipërfaqeve të fasadave me material të përshtatshëm fasadash (fasadex ose bavalit, pra ekuivalentët e tyre) dhe
2. kryhen punime në hidroizolimimin dhe termoizolimimin e çatisë.

Me punimet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk ndikohet në stabilitetin dhe sigurinë e objektit, nuk ndryshohen elementet e konstruktit, nuk ndryshohet pamja e jashtme në

raport me projektin e ndërtesës dhe nuk ndikon në sigurinë e objekteve fqinje, komunikacion, mbrojtjen nga zjarri dhe mjediisit.

Neni 4

Adaptimi kryhet në tërësi në ndërtesat si njësi arkitektonike, si rregull, me materiale të njëjta ose të ngjashme me materialet origjinale, me mendimin paraprak të organit të qeverisjes vendore përgjegjëse për dhënien e pëlqimit në lidhje me përputhjen e ndërtesës me direktivat për projektimin dhe materializimin.

Për t'u mbrojtur nga ndikimet e jashtme klimatike dhe atmosferike, Adaptimi duhet të bëhet nga materiale që plotësojnë standardet për termoizolim dhe hidroizolim.

Adaptimi nënkupton bashkfinancimin e të gjitha punimeve të nevojshme për rinovimin e pjesëve të jashtme të ndërtesës në lidhje me tipin, formën, llojin e ndërtesës dhe llojin e materialit nga i cili janë ndërtuar, përveç:

- blerjes së elementeve të reja të zdrukthtarisë dhe dyerëve dhe dritareve (dritaret, dyert, muret me xham, strukturat mbajtëse të sistemeve të fasadave me material montazh, parrmakët e tjerë) të cilat instalohen ose në murin e jashtëm ose në skaj të ndërtesës kah hapësira e pa ngrohur;
- rindërtimi strukturor i ndërtesës.

Pronarët e pjesëve të veçanta të ndërtesës në tërësi e dinancojnë blerjen e elementeve të zdrukthtarisë dhe dyerëve dhe dritareve të fasadave (dritaret, dyert, muret me xham, strukturat mbajtëse të sistemeve të fasadave me material montazh, parrmakët e tjerë) të cilat instalohen ose në murin e jashtëm ose në skaj të ndërtesës kah hapësira e pa ngrohur, ndërtimin e ullqeve horizontale dhe vertikale dhe rindërtimin strukturor të ndërtesës.

II DISPOZITA TË VEÇANTA

Konkursi publik

Neni 5

Bashkëfinancimi i adaptimit bëhet në bazë të konkursit publik (në vijim: "Konkursi").

Vendimin për shpalljen e konkursit (tenderit) e merr Kryetari i Komunës së Ulqinit nëse me Buxhet për atë vit janë parashikuar mjete për atë qëllim.

Konkursi mund të shpallet disa herë gjatë vitit kalendarik në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës.

Konkursi përmban kushtet e pjesëmarrjes, përshkrimin e punëve të adaptimit, lartësinë maksimale të mjeteve financiare të bashkëfinancimit dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave të arritura.

Konkursi (tenderi) shpallet në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Ulqinit dhe në mjetet lokale të informimit publik, me një afat prej të paktën 60 ditë.

Organi i administratës lokale kompetent për çështjet banesore është i detyruar, pas shpalljes së konkursit, me shkrim të lajmërojë të gjithë administratorët e regjistruar të godinave (ndërtesave) të banimit dhe atyre të banimit dhe biznesit në territorin e Komunës së Ulqinit për konkursin e shpallur, me qëllim të informimit më të mirë dhe sigurimin e barazisë.

Neni 6

Të drejtën e pjesëmarrjes në ftesë e kanë organet drejtuese në objektet banesore dhe banesore-afariste që janë themeluar në përputhje me ligjet që rregullojnë pronësinë dhe mirëmbajtjen e objekteve të banimit dhe që nuk kanë marrë mjete nga Komuna e Ulqinit për bashkëfinancimin e kësaj lloj pune në 10 vitet e fundit, ose Komuna e Ulqinit nuk i ka kryer këto punë në 10 vitet e fundit.

Komisioni

Neni 7

Për zbatimin e procedurës së bashkëfinancimit të adaptimit Kryetari i Komunës emëron Komisionin.

Komisioni ka kryetarin dhe gjashtë anëtarë, prej të cilëve dy anëtarë janë nga radhët e inxhinierëve të arkitekturës dhe ndërtimtarisë dhe nga një ekonomist dhe një jurist të diplomuar, prej të cilëve së paku njëri duhet të jetë përfaqësues i organit kompetent për çështje banesore i Komunës së Ulqinit.

Komisioni ka detyrë të:

- përgatisë tekstin e konkursit;
- të përcaktojë gjendjen e ndërtimit dhe të vlerësojë urgjencën e punimeve në pjesët e jashtme të ndërtesës në lidhje me gjendjen;
- vlerëson gjendjen e objektit sipas kriterëve të përcaktuara me këtë vendim dhe konkurs;
- konfirmojë nëse propozimi i tonalitetit të ngjyrës është i përshtatshëm, përkatësisht t'i propozojë menaxherit të ndërtesës zëvendësimet e përshtatshme të tonalitetit të ngjyrave;
- konfirmojë draft listën e përparësive të bashkëfinancimit të adaptimit;
- shqyrtojë ankesat e pjesëmarrësve në konkurs të parashtruara në draft listën e përparësive;
- konfirmojë propozim listën e përparësive të bashkëfinancimit të adaptimit;
- të konfirmojë shumën mjeteve financiare për bashkëfinancim të adaptimit;
- t'i propozojë organit të administratës lokale kompetent për çështjet banesore pjesëmarrjen në bashkëfinancim të adaptimit;
- pas dorëzimit të raportit të mbikëqyrjes për punët e kryera, e viziton objektin ku janë kryer punimet dhe të hartojë një raport për te dhe t'ia dorëzojë organit kompetent të administratës lokale;

Mandati i Komisionit është dy vjet.

Pushimi i mandatit të anëtarëve të komisionit

Neni 8

Anëtarit të Komisionit i pushon mandati, para skadimit të kohës për të cilën është emëruar, në rastet:

- e dhënies së dorëheqjes, për të cilën gjë e njofton kryetarin e komisionit;
- nëse i hiqet aftësia e punës me një vendim të plotëfuqishëm ose është dënuar me burgim të pakushtëzuar prej të paktën gjashtë muajsh;
- në rast të shkarkimit.

Procedurën për shkarkimin e anëtarit të komisionit e inicon Kryetari i Komunës, me

propozimin e organit të administratës lokale kompetent për çështje banesore ose me propozimin e kryetarit të komisionit, dhe atë në rast se nuk e ushtron funksionin e anëtarit të Komisionit në një periudhë më të gjatë se 6 muaj.

Në rast të pushimit të mandatit të anëtarit të komisionit para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, Kryetari i Komunës është i detyruar të emërojë një anëtar të ri të Komisionit brenda 15 ditëve nga data e pushimit të mandati, mandati i të cilit zgjat deri në skadimin e mandatit të Komisionit.

Kriteret për përcaktimin e listave prioritare

Neni 9

Kriteret për përcaktimin e listës prioritare të adaptimit të fasadave të ndërtesave të banimit dhe banesore-afarist janë të caktuara sipas grupeve dhe secili grup ndahet në nëngrupe që vlerësohen me ndarjen e pikëve në mënyrën si më poshtë:

1. Vendndodhja e ndërtesës:

- a) Ndërtesat në vëllimin e PDU “Meraja 1” 50 pikë;
- b) Ndërtesat në vëllimin e PDU “Meraja 2” 50 pikë;
- c) Ndërtesat në vëllimin e PDU “Totoshi” 45 pikë;
- d) Ndërtesat në vëllimin e PDU “Pristan” 45 pikë;
- e) Ndërtesat e tjera të banimit në territorin e Komunës së Ulqinit 30 pikë.

2. Gjendja ndërtimore e fasadave

- a) E dëmtuar në tërësi 50 pikë;
- b) Është e dëmtuar më shumë se 50% 40 pikë;
- c) Pjesërisht e dëmtuar, e dëmtuar më pak se 50% e sipërfaqes 30 pikë;
- d) Gjendje e knaqshme 1 pikë.

3. Viti i ndërtimit të ndërtesës/vjetërsia e ndërtesës nëse dihet ose sipas karakteristikave ndërtimore

- a) Më e vjetës se 50 vjet 50 pikë;
- b) Prej 41 deri 50 vjet 45 pikë;
- c) Prej 31 deri 40 vjet 40 pikë;
- d) Prej 21 deri 30 vjet 30 pikë;

4. Vlerësimi i përgjithshëm i urgjencës së rinovimit të fasadës, duke marrë parasysh gjendjen:

- a) Restaurim shumë urgjent 50 pikë;
- b) Restaurim urgjent 40 pikë;
- c) Restaurim më pak urgjent 30 pikë;
- d) Restaurimi duhet, por nuk është urgjent 20 pikë.

Komisioni mund të përcaktojë edhe kritere të tjera për përcaktimin e listës së Përparësive nëse diçka e tillë është e arsyeshme, me mendimin paraprak të organit të administratës lokale për çështje banesore.

Kriteret për hartimin e listës së përparësive për punimet e hidroizolimit dhe termoizolimit të çatisë do të përcaktohen me Konkurse (tender).

Dokumentacioni për pjesëmarrje në Konkurs

Neni 10

Bashkë me kërkesën për bashkëfinancim të adaptimit së fasadës së objektit, menaxheri është i detyruar të paraqesë të dhënat dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Aktvendimin për emërimin e menaxherit të ndërtesës;
- Numri amzë dhe shifra e veprimtarisë së ndërtesës e lëshuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për çështje të statistikës;
- Ekstraktin nga fleta e patundshmërive me kopjen e planit të parcelës kadastrale jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Propozimin e tonaliteteve të ngjyrës nga katalogu i prodhuesit me shifrën përkatëse;
- Vendimin e kuvendit të pronarëve të banesave për pjesëmarrjen në konkurs;
- Vendimin e kuvendit të pronarëve të banesave për pjesëmarrjen në konkurs, i marrë me pëlqimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit dhe procesverbali me votanënshkrimet e paraqitura, të vërtetuara me vulën e kuvendit të pronarëve të banesave. Nëse ndërtesa si tërësi arkitekturore ka më shumë hyrje me organet e administrimit të formuara është e nevojshme të dorëzohen vendime individuale për pjesëmarrjen në konkursin publik për çdo hyrje.
- Vendimi për pjesëmarrjen e përbashkët në Konkurs, të cilin e nënshkruajnë administratorët e hyrjeve, si një akt unik (i domosdoshëm në rast se në një ndërtesë banimi me disa hyrje ka më shumë se një organ menaxhues);
- Ekstraktin nga banka me të cilin dëshmohet se në llogarinë e pronarëve të banesave janë siguruar, së paku 30% e mjeteve për realizimin e punëve të planifikuara;
- Deklaratën e menaxherit të ndërtesës dhe vendimin e kuvendit të pronarëve të banesave se deri me përfundimin e punimeve do të sigurojnë pjesën e mbetur të mjeteve financiare;
- Tri oferta, me paramatje, paralogari dhe përshkrim të punëve nga një subjekt ekonomik i autorizuar përkatësisht licensuar për ekzekutimin e këtyre punëve.

Draft lista e përparësive

Neni 11

Shqyrtimin e kërkesave të mbërritura dhe konfirmimin e listës së përparësive do ta bëjë Komisioni në afat prej 20 ditësh nga dita e skadimit të Konkursit.

Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk është komplet, Komisioni me shkrim do të kërkojë nga menaxheri i ndërtesës plotësimin e dokumentacionit, të cilin menaxheri është i detyruar ta dorëzojë në afat prej 5 ditësh nga dita e dorëzimit të ftesës për plotësimin e dokumentacionit.

Nëse menaxheri nga paragrafi 2 i këtij neni nuk e plotëson dokumentacionin, do të konsiderohet sse pronarët e pjesëve të veçanta të ndërtesës janë tërhequr nga bashkëfinancimi i Adaptimit, e ndërtesa do të fshihet nga lista e përparësive.

Kërkesat e pakompletuara dhe jashtë kohe nuk do të rangohen (renditen).

Neni 12

Draft lista e përparësive konfirmohet sipas numrit të pikëve të ndara.

Draft lista e përparësive do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Ulqinit.

Pjesëmarrësit në konkurs në afat prej 5 ditësh nga dita e publikimit të listës së përparësive nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i parashtrojnë ankesë Komisionit.

Komisioni është i detyruar që në afat prej 5 ditësh nga dita e marrjes, të shqyrtojë ankesën në draft listën e përparësive dhe të konfirmojë listën përfundimtare të përparësive.

Nëse dy ndërtesa kanë të njëjtin numër pikësh, përparësi do t'i jepet objektit që ka më shumë pikë sipas kriterit të vendndodhjes së ndërtesës, dhe nëse dy ndërtesa në të njëjtin vend kanë të njëjtin numër pikësh, përparësi do t'i jepet objektit që është më i vjetër dhe pastaj ndërtesa në të cilën gjendja e ndërtimit të fasadës është e keqe.

Nëse dy apo më shumë ndërtesa kanë numër të njëjtë pikësh sipas të gjitha kriterëve zgjedhja e ndërtesës do të bëhet me short, me prezencën e menaxherëve të atyre ndërtesa.

Raporti i Komisionit

Neni 13

Në bazë të propozimit të përcaktuar të listës së prioriteteve, Komisioni përgatit një raport për konkursin për bashkëfinancimin e Adatimit dhe ia paraqet organit të administratës vendore përgjegjës për çështjet banesore.

Raporti nga paragrafi 1 i këtij neni në veçanti përmban: emrin e menaxherit të objektit banesor, adresën, mënyrën e pikëzimit dhe shumën e mjeteve për bashkëfinancim.

Aktvendimi për bashkëfinancim

Neni 14

Aktvendimin për pjesëmarrjen në bashkëfinancimin e Adaptimit, me propozim të Komisionit, e merr organi i qeverisjes vendore përgjegjës për çështjet banesore.

Aktvendimi nga paragrafi 1 i këtij neni dhe lista përfundimtare e përparësive publikohet në faqen e internetit dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Ulqinit.

Kontrata për kryerjen e punëve

Neni 15

Pasi që aktvendimi nga neni 14 paragrafi 1 të bëhet i plotëfuqishëm, menaxheri i ndërtesës lidh kontratën me ofertuesin e përzgjedhur.

Me kontratë definohen të drejtat dhe detyrimet e organit i cili menaxhon ndërtesën e banimit dhe ofertuesit të përzgjedhur.

Kontrata për bashkëfinancim

Neni 16

Pasi që aktvendimi nga neni 14 paragrafi 1 të bëhet i plotëfuqishëm, organi i administratës lokale kompetent për çështje banesore do ta ftojë menaxherin që të lidh kontratën për bashkëfinancimin e Adaptimit (në vijim: "Kontrata").

Me Kontratën në mes Komunës së Ulqinit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës dhe pronarëve të pjesëve të veçanta të ndërtesës, të cilët i përfaqëson menaxheri i ndërtesës, rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

Dinamika dhe mënyra e pagesës së mjeteve të miratuara në llogarinë e pronarëve të pjesëve të veçanta të ndërtesës do të konfirmohet me Kontratë.

Nëse menaxheri nuk i përgjigjet ftesës dhe nuk e lidh kontratën nga paragrafi 1 i këtij neni, në afat prej 5 ditësh nga dita e pranimit të ftesës, konsiderohet se ndërtesa ka hequr dorë nga bashkëfinancimi i Adaptimit dhe mjetet i ndahen godinës së radhës në listën e përparësive.

Kontrata publikohet në faqen e internetit dhe tabelën e shpalljeve të Komunës së Ulqinit.

Neni 17

Punimet e definuar me kontratë nga nenet 15 dhe 16 të këtij vendimi, duhet të kryhen në përputhje me propozimin nga neni 10, paragrafi 1, alinea 5, i cili është pranuar nga Komisioni.

Çdo ndryhim i shifrës së tonalitetit dhe/ose prodhuesit të ngjyrës duhet të miratohet nga ana e Komisionit.

Neni 18

Të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit të dokumentacionit nga neni 10 i këtij vendimi përballohen plotësisht nga pronarët e pjesëve të veçanta të objektit.

Shpenzimet që nuk janë paraparë me ofertë dhe përshkrimin e punëve përballohen plotësisht nga pronarët e pjesëve të veçanta.

Shpenzimet e mbikëqyrjes profesionale mbi kryerjen e punëve në Adaptim në pajtim me Kontratën përballohen nga pronarët e pjesëve të veçanta.

Neni 19

Pronarët e pjesëve të veçanta të objektit duhet të përdorin mjetet e akorduara për Adaptim jo më vonë se 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës të parashikuar në nenin 16 të këtij vendimi.

Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rast të arsyeve të justifikuara dhe në bazë të mendimit të Komisionit, Kryetari i Komunës mund ta shtyjë afatin nga paragrafi i këtij neni.

Neni 20

Komisioni ka të drejtë në shpërblim për punën.

Shuma e kompensimit përcaktohet nga Kryetari i Komunës me akt të veçantë, në bazë të vëllimit dhe kompleksitetit të punës së kryer nga Komisioni.

III DISPOZITAT KALIMTARE

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunave”.

Numër: _____

Ulqin, më _____.____.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetarja

Ivana Popović d.v.

A R S Y E T I M

Baza ligjore për hartimin e Vendimit për bashkëfinancimin e adaptimit të pjesëve të jashtme të objekteve në territorin e Komunës së Ulqinit gjendet në nenin 27 pika 10 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/20, 84/22), me të cilin parashikohet që Komuna, në pajtim me Ligjin dhe dispozitat e tjera rregullon raportet në fushën e banimit dhe kujdeset për sigurimin e kushteve për mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit.

Arsyja për marrjen e këtij, krahas funksionit estetik, pasqyrohet në sigurimin e kushteve më të mira të banimit dhe afarizimit përmes rritjes së efikasitetit energjetik të ndërtesave të banimit dhe banimit e afariste në territorin e Komunës së Ulqinit.

Në dispozitat e përgjithshme është konfirmuar se Komuna mund të fillojë procedurën e bashkëfinancimit të adaptimit të pjesëve të jashtme të ndërtesave vetëm nëse me buxhetin vjetor të Komunës së Ulqinit janë parashikuar mjete për këtë qëllim, deri në 50% të vlerës së paralogaritur të punimeve të paraqitura në ofertë e kryesit të punimeve, e më së shumti 25.000,00 € me TVSH-në e llogaritur, si dhe ndërtesat më të vjetra se 30 vjet munden, me propozim të Komisionit për arsye të avancimit estetik, përmirësimit të sigurisë dhe interesit publik të financohen deri 70 % në zonën e PDU "Meraja 1", PDU "Totoshi" dhe PDU "Pristan" nga vlera e paralogaritur e punimeve të paraqitura në ofertë, e më së shumti deri 40.000,00 € me TVSH-në e llogaritur.

Përjashtimisht Komuna mund të financojë edhe deri 100 % të vlerës së paralogaritur të punimeve, nëse vlerëson se ekziston një interes publik i veçantë, posaçërisht me qëllim të avancimit estetik, përmirësimit të sigurisë apo ruajtjen e pronës publike.

Punët që mund të bashkëfinancohen nga Komuna e Ulqinit, në aspektin e këtij vendimi janë trajtimi i sipërfaqeve të fasadës me material të përshtatshëm për fasada (fasadeks ose bavalit, përkatësisht ekuivalentët e tyre) dhe punimet në hidroizolim dhe termoizolim të çative.

Me dispozita të veçanta parashikohet procedura për bashkëfinancimin e adaptimit, e cila kryhet në bazë të konkursit publik të cilin e realizon komisioni i formuar nga kryetari i komunës së Ulqinit. Për të zbatuar më me kompetencë procedurën e konkurrimit, u konfirmua se komisioni ka kryetarin dhe gjashtë anëtarë, nga të cilët dy anëtarë janë inxhinierë të arkitekturës dhe ndërtimtarisë dhe nga një ekonomist i diplomuar dhe jurist i diplomuar.

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs, kanë vetëm organet menaxhese të ndërtesave të banimit që janë formuar në pajtim me ligjin.

Po ashtu, janë konfirmuar edhe kriteret për adaptim të fasadave të ndërtesave të banimit dhe banimit e afariste sipas grupeve, përkatësisht nëngrupe dhe atë:

- Lokaliteti i ndërtesës,
- Gendja ndërtimore e fasadës,
- Viti i ndërtimit të ndërtesës / vjetërsia e ndërtesës nëse dihet ose sipas karakteristikave të ndërtimit,
- vlerësimi i përgjithshëm i urgjencës së rinovimit të fasadës, duke marrë parasysh gjendjen

Procedura e bashkëfinancimit parashikohet në atë mënyrë që pas shqyrtimit të kërkesave të pranuar, komisioni të përcaktojë draft listën e prioriteteve sipas numrit të pikëve të akorduara dhe më pas, pas çdo ankesave për draft listën, përcaktohet lista përfundimtare. Në bazë të propozimit të përcaktuar të listës së prioriteteve, komisioni përgatit një raport për konkursin e realizuar dhe ia paraqet organit të qeverisjes vendore përgjegjëse për çështjet banesore, i cili merr vendim për bashkëfinancimin. Me marrjen e formës së prerë të këtij vendimi, menaxheri i objektit lidh kontratë për kryerjen e punëve me kontraktues të autorizuar dhe kontratë për bashkëfinancim me kryetarin e Komunës së Ulqinit, e cila ndër të tjera përcakton mënyrën dhe dinamikën e pagesës së mjeteve të miratuara.

Përveç sa u tha më sipër, është përcaktuar që shpenzimet që nuk parashikohen me ofertë dhe përshkrimin e punëve përballohen plotësisht nga pronarët e pjesëve të veçanta.

SEKRETARIATI PËR VEPRIMTARI KOMUNALE DHE BANESORE